

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEGA NË SHTËRPECË,
DEPARTAME-NTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL, gjyqtari Musa Konxheli, me asistentin Muedin Rexhepi, në lëndën penale kundër A. R.1; nga fshati... komuna e Shtërpces dhe kunder A. R.2; nga f... Komuna Shtërpces, i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.2276-5/16 të dt.29.08.2017, sipas së cilës e ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par.1. lidhur me nenin 31. të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj për dhënien e urdhërit ndëshkimor, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, më dt.11.09.2017. solli

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.2276-5/16 e dt.29.08.2017. dhe kjo gjykatë jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari **A. R.1;** nga fshati... komuna e Shtërpces, i lindur më data e lindjes..., në të njëjtin vend, nga i ati ... , i nacionalitetit shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri,

I akuzuari **A.R.2;** nga fshati ... komuna e Shtërpce, i lindur më data e lindjes, në të njëjtin vend, nga i ati X ... i nacionalitetit shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri,

ËSHTË FAJTORE

Sepse me dt.03.11.2016.rreth orës 11:10 në pyllin publik,në vendin quajtur “Bukova”në rajonin Ekonomiko Pyjor Brod-Firaj,është takuar duke prerë 3 copë dru të ahut të njomë me diametër 44-46 m,e me vëllim të përgjithshëm prej 3.09 metra kub,në vlerë prej 417.15 € drunjte kanë qen të prerë me sharrë motorike e të bartura me xhip.

- me çka ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par.1 lidhur me nenit 31 të KPRK-së.
- Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 43, 46 dhe 73 të KPRK-së dhe nenit 495 të KPPRK-së,

G J Y K O N

1.Të akuzuarit **A.R.1;** i shqiptoi dënimin në shumën prej 200 € (dyqind Euro), të cilën shumë i akuzuari obligohet t’a paguan në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

2.Të akuzuarit **A.R.2;** i shqiptoi dënimin në shumën prej 200 € (dyqind Euro), të cilën shumë i akuzuari obligohet t’a paguan në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do t’i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro, do t’i llogaritet nga një (1) ditë burgim.

Obligohet i akuzuarit që të dëmtuarës Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik në Shtërpcë t'ia kompenson dënim e shkakuar në vlerë prej 417,15 €, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqi-shmërisë së aktgjykimit.

Obligohet i akuzuarit të paguan shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjy-qësor në shumë prej 20 €, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjy-kimi, të gjitha këto nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP.nr.2276-5/16 të dt.29.08.2017 ka akuzuar A.R.1; nga fshati... komuna Shtërpcë dhe akuzuar A.R.2; nga fshati... komuna Shtërpcë , se ka kryer veprën penale vjedhje pyllit nga neni 358 par.1 lidhur me nenin 31. të KPRK-së dhe ka parashtruar kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallximi panal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i akuzuari.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkeses për dhënien e urdhrit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par.1.2 dhe 3 të KPPK-së.

Gjykata duke i shikuar provat materiale të bashkëngjitura në shkresat lëndës gjegjë-sisht fletparaqitjes së ushtruar nga ana e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik në Shtërpcë me nr.280/2016 të dt.14.11.2016 dhe procesverbalin me numër të njejtë konstatoi se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i akuzari ka kryer veprën penale pën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dëni-min me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në mbështetje të nenit 463 par.2 të KPRK-së e ka obliguar të akuzuarin që të dëmtuarës Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik në Shtërpcë, t'ia kompenson dënim e shkak-tuar në shumë prej 417,15 €, në afat prej 15 ditësh nga dita plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjy-qësor është sjellë në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEGA NË SHTËRPCË P.nr.191/2017 i dt.11.09.2017

Asistent
Muedin Rexhepi

Gjyqtari
Musa Konxheli

KËSHILLË JURIDIKE:

Kudër këtij aktgjykimi lejohet kundërshtimi në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të dërgesës së të njëjtit, gjyqtarit të vetëm gjykues të kësaj gjykate, përmes kësaj gjykate. Pas skadimit të afatit të lejuar për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor bëhet i plotfuqishëm dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar.